

Mësimdhënia në FASTIP

Pyetje:

Kush janë profesorët e FASTIP-it?

Përgjigje:

Në FASTIP japin mësim profesorë të huaj të ftuar që vijnë nga universitete europiane apo amerikane si dhe profesorë vendas. Ata u transmetojnë studentëve njohuritë më të reja shkencore.



Pyetje:

Çfarë përfiton studenti që studion në FASTIP?

Përgjigje:

- Përgatitje nga një profesori me përvojë në universitetet më në zë të Europës dhe Amerikës,
- Dijeni shkencore bashkëkohore,
- Përvojë pune në profesion,
- Mundësi studimi të mëtejshme në programe Master/Doktoraturë brënda apo jashtë vendit.

Pyetje:

Me çfarë diplome pajiset një student i FASTIP-it?

Përgjigje:

Pas përfundimit të programit tre vjeçar të studimit, studenti pajiset me diplomën Bachelor (diplomë me 180 kredite) lëshuar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës.

FASTIP-i

Pyetje:

Ç'është FASTIP-i?

Përgjigje:

Institucion publik që ofron studime universitare duale. FASTIP është një nga gjashtë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Përgatitje profesionale të orientuar në praktikë në bashkëpunim me biznesin!

Pyetje:

Çfarë ka të veçantë FASTIP-i?

Përgjigje:

- Arsimit dual (studime të integruara me praktikën),
- Studimin në kushte bashkëkohore,
- Mësimdhënie në gjuhën angleze,
- Mësimdhënie nga profesorë të huaj dhe vendas,
- Punësim i garantuar i të diplomuarve.
- Studenti i FASTIP-it gëzon status të dyfishtë: Student dhe Punonjës i Kompanisë.

**Adresa: Lagjja nr.17,
Rr. Adria, (pranë Urës së Dajlanit) Durrës
E-mail: info@fastip.edu.al**

fastip
Fakulteti i Studimeve të
Integruara me Praktikën



**Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën
(FASTIP)**



FASTIP-i ofron tre programe studimi:

- Menaxhim i Bankave,
- Menaxhim i Hoteleri-Turizëm,
- Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Për më shumë informacion klikoni në:

www.fastip.edu.al

Për më shumë informacion klikoni në:

www.fastip.edu.al

Për më shumë informacion klikoni në:

www.fastip.edu.al

Për t'u pranuar në FASTIP

Pyetje:

Cilat janë kriteret për t'u pranuar në FASTIP?

Përgjigje:

- Maturanti duhet të ketë notën e anglishtes në provimin e Maturës Shtetërore mbi 6,
- Maturanti duhet të konkurojë për në FASTIP,
- Konkursi zhvillohet nga kompanitë partnere dhe përmban test me shkrim në gjuhën angleze dhe intervistë punësimi.

FASTIP

Zgjedhja më e mirë për karrierën tuaj profesionale!

Pyetje:

Si shpallesh student në FASTIP?

Përgjigje:

- Maturanti ka shansin të jetë student i FASTIP-it nëse kompania e vlerëson me 40-100 pikë në konkurs.
- Mbështetur në rezultatet e konkursit dhe notës së gjuhës angleze në Maturën Shtetërore bëhet përlllogaritja e pikëve për të shpallur maturantin student të FASTIP-it.


Konkurimi në kompani

Pyetje:

Në cilat kompani mund të konkurohet?

Përgjigje:

Në kompanitë partnere të FASTIP-it:
Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Raiffeisen Bank, Banka Credins, Vodafone Albania, Telekom Albania, Harmonia Hotels-Group etj.



Pyetje:

Nëse kompanitë partnere të FASTIP-it nuk të shpallin fitues a ka ndonjë mundësi tjetër për t'u regjistruar në FASTIP?

Përgjigje:

Po. Maturanti mund të konkurojë në çdo kompani tjetër të gjetur prej tij (në qytetin e vet apo me gjerë) me fushë veprimtarie të njëjtë me programin e përzgjedhur të studimit.

Detyrimet e kompanisë

Pyetje:

Kush janë detyrimet e kompanisë?

Përgjigje:

- Aktivizimi dhe trajnimi i studentit në çdo proces pune në kompani,
- Vlerësimi sistematik me notë i performancës së studentit në trajnimin profesional në kompani,
- Financimi i tre viteve të studimit.



Pyetje:

Për çfarë përdoren financimet e kompanisë?

Përgjigje:

- Për të përballuar pagesën dhe akomodimin e profesorëve të huaj të ftuar,
- Për përmirësimin e teknologjisë së mësimdhënies.

Kompanitë Partnere:

